



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 131/13
Prishtinë, më 13.11.2013, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadergjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontic, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, dhe Xhevdet Neziraj, Duda Balje dhe Sevdije Lama.

Munguan: Sali Asllanaj, Albana Fetoshi, dhe Hykmete Bajrami.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini, Bashkim Kurtaj, Dashurije Canolli, Imba Rudaku (praktikante) dhe Arbëreshë Kosumi (praktikante).

Gjithashtu ishin të pranishëm: Besim Beqaj Ministër i Financave, Agim Krasniqi, Petrit Popova, Qerkin Berisha nga MF, përfaqësues të medieve, Rejhane Zylfijaj nga GIZ.

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadergjonaj, Kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2014;**
- 3. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja konstatoi se rendi i ditës miratohet njëzëri.

2. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2014

Kryetarja nëse analizojmë Projektbuxhetin për vitin 2014, shohim se të hyrat buxhetore janë planifikuar prej 1.45 miliard euro. Në kuadër të hyrave, dogana parashihet që të mbledhë 934.1 milion apo 21.4 milion më shumë krahasuar me vitin 2013 që parashihet rritje për 2%. Sa i përket të hyrave vendore që planifikohen të inkasohen nga ATK, shohim se është paraparë të inkasohen 367.3 milion krahasuar dhe kemi një rritje prej 66.3 milion euro. Të hyrat jo tatimore janë rreth 192.5 milion euro. Sa i përket shpenzimeve, shpenzimet e përgjithshme, përfshirë edhe shpenzimet për AKP-në që janë ndarë rreth 7 milion euro si të hyra të dedikuara, janë 1.590 miliard euro. Në kuadër të shpenzimeve, shohim se janë përfshirë edhe një numër i projekteve, që arrijnë vlerën prej 38 milion, të cilat do të financohen përmes

kredive nga ana e partnerëve ndërkombëtar dhe janë projekte kryesisht të orientuara për përmirësimin e infrastrukturës. Sa i përket kategorive, për paga edhe mëditje janë paraparë 483.4 milion euro, transfere dhe subvencione janë parapa 313.7 milion euro, mallra dhe shërbime 251.8 milion euro, kurse për shpenzime kapitale janë paraparë 530 milion euro.

Besim Beqaj njoftoi se propozim buxheti është përgatitur në pajtim të plotë me Fondin Monetar Ndërkombëtar. Ne presim që edhe në vitin 2014 dhe vitet në vijim, ekonomia e Kosovës të vazhdoj me ritmet e saja pozitive të rritjes, të jetë ndër më të lartat në rajon (2014 4.1%; mesatarja për tri vite 4.6%), duke u bazuar në projeksionet tona për rritje të Investimeve, Eksporteve dhe Konsumit. Investimet private, si një komponentë shumë e rëndësishme e rritjes ekonomike pritet që gjatë tri viteve të ardhshme të rriten nominalisht me një normë mesatare prej rreth 10% (2014=11.3%). Eksportet totale në vitin 2014 pritet të kenë një rritje prej rreth 7% ndërsa vetëm eksportet e mallrave, do të rriten rreth 10%. Konsumi agregat për vitin 2014 dhe dy vitet në vijim pritet të ketë një rritje mesatare prej rreth 6.2%, dhe po ashtu të njëjtën rritje pritet të ketë edhe konsumi privat. Për vitin e ardhshëm, projeksionet tona që marrin parasysh edhe pritjet për ecurinë e çmimeve të importit, tregojnë se do të kemi një ngritje modeste të çmimeve për rreth 1.5%. Niveli i këtyre dërgesave apo remintacave parashikohet të jetë stabil.

Për vitin 2014, të hyrat e përgjithshme buxhetore planifikohen të jenë në nivel prej 1 miliard e 458 milion euro, (apo një rritje prej rreth 2.5% krahasuar me vitin 2013). Në kuadër të të hyrave totale, të hyrat nga tatimet e brendshme dhe ato doganore pritet të rriten me rreth 7%, ndërsa vetëm të hyrat e brendshme pritet të rriten me rreth 22%. Rritje planifikohet të ketë edhe tek të hyrat tjera buxhetore, duke përfshirë të hyrat jo-tatimore (8.5%) dhe të hyrat vetanake të Komunave (6.7%), ndërsa është planifikuar një rënie në të hyrat vetanake të nivelit qendror (-31%), që reflekton pritjet për të hyra të njëhershme në këtë vit, e që nuk do të kemi të njëjtën vitin e ardhshëm. Sa i përket shpenzimeve, në total shpenzimet për vitin 2014 pritet të jenë në nivelin prej 1 miliardë e 590 milion euro, që paraqet një rritje të lehtë krahasuar me vitin 2013. Shikuar nga këndvështrimi i kategorive ekonomike, buxheti për Paga dhe Mëditje pritet të ketë një rritje të konsiderueshme nga 435 milion euro në vitin 2013 në 483.4 milion euro në vitin 2014. Ky buxhet reflekton zotimin e Qeverisë për rritje të pagave të të gjithë shërbyesve civil, duke marrë parasysh performancën dhe efektivitetin e punës së tyre. Rritje është planifikuar edhe në kategorinë e Mallrave dhe Shërbimeve (nga 225 milion në vitin 2013, në 252 milion në 2014 apo një rritje prej 12%). Kjo bëhet me qëllim të reflektimit të nevojës për përkrahje të reformave në sektorin e sigurisë dhe drejtësisë, shëndetësisë, arsimit si dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së zgjeruar rrugore, të shkollave, objekteve të administratës publike, etj. Gjithashtu, edhe kategoria e Subvencioneve dhe Transfereve është planifikuar që të rritet nga 299 në 316 milion euro (një rritje prej 5.7%). Kjo rritje shkon për përkrahjen e rritjes natyrale të skemave ekzistuese, skemave të reja sociale (ish të ndjekurit politik dhe skema për veteranet e luftës). Sa i përket shpenzimeve kapitale, ato pritet të jenë në vlerë prej 531 milion euro dhe pjesëmarrja e shpenzimeve kapitale në shpenzimet e përgjithshme buxhetore mbetet edhe më tutje e lartë në rreth 33%. Do të vazhdohet me investime në infrastrukturën rrugore, duke përfshirë edhe Autostradën në drejtim të Maqedonisë si dhe ndërtimin e shumë projekteve tjera të rëndësishme në mesin e tyre edhe ndërtimin e rrugëve M2 dhe M9, respektivisht rrugët për Mitrovicë dhe Pejë. Është me rëndësi të theksohet se ky propozim Buxhet, parasheh edhe financimin e projekteve sipas prioriteteve të të gjitha Komunave. Nga materiale që keni para jush, Tabela pasqyron buxhetin e komunës së Rahovecit dhe Hanit të Elezit, të cilat komuna nuk kanë arritur të aprovojnë buxhetin në Kuvendet Komunale. Si rrjedhojë, duke u bazuar në nenin 62 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, është marrë për bazë niveli i Buxhetit 2013 për këto dy komuna. Me anë të këtij propozim-buxheti, mundësohet respektimi në tërësi i Rregullës fiskale i cili kufizon deficitin e përgjithshëm buxhetor në 2% të BPV-së i cili është paraparë me Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi. Në të njëjtën kohë përmes implementimit të kësaj rregulle sigurohet një qëndrueshmëri afat-gjate të financave publike të vendit. Besojmë se me këtë

propozim-buxhet kemi arritur që t'i financojmë kërkesat me prioritet të secilës organizatë buxhetore dhe njëkohësisht të ruajmë stabilitetin buxhetor që është parakusht për rritje të qëndrueshme ekonomike.

Naser Osmani sa i përket pjesës tekstuale, te neni 4 të ndarjet buxhetore komunale që ka të bëjë me komunitetet e reja ne paragrafin 5 ku ndër tjera thuhet se do të merret pëlqimi edhe i përfaqësuesve të popullatës në zonat kadastrale, dhe sipas kushtetutës e ligjeve nuk njihet e drejta e përfaqësuesve, por njohin institucionet. Kjo ka të bëjë me përfaqësuesit serb në pjesën veriore të cilën e kemi një marrëveshje që duhet përkrah apo këtu është bërë një përvjedhje e juaja, dhe për mua krijon dilema të mëdha se kush janë këta përfaqësues kadastral në zonat e caktuara. Ne kemi debatuar fondin për pjesën e veriut që ka të bëjë me nenin 7.3, e kuptoj marrëveshjen e dhe ajo që unë kam kërkuar në atë kohë edhe tash insistoj edhe pse është kundër Kushtetutës ka të bëjë me grumbullimin e dy pikave doganore dhe mbajtjen e mjeteve në bankën komerciale, ajo është një filial e bankës së Beogradit në Mitrovicë dhe në mënyrë të dyshimtë është regjistruar në Bankën Qendrore. Te neni 10 paragrafi 3 është mirë i shkruajtur që 10% në nëntor dhe 5% në dhjetor mos të ketë zotime, por mendoj që duhet ashpërsuar këtë nen në kuptimin që mos të lejohet cildo kryetar që të abuzoj me mjetet publike për qëllime të fushatës edhe për qëllime të veta.

Ajo që duhet me diskutue është çështja e 5% e mjeteve të cilat me vendim të ministrisë dhe me aprovim të qeverisë po shkurtohen dhe po ridestinohen për nga një organizatë buxhetore në tjetrën. Unë mendoj që duhet intervenuar në këtë paragraf dhe duhet theksuar se çdo ndërhyrje në ligjin e buxhetit, duhet të nënshtrohet votimit në Parlament. Një qështje tjetër që ka të bëjë me kompetencat e kryetareve të komunave kur vendosin për mjetet që janë tepër të investimet kapitale dhe këtë mund ta bëjnë brenda 5 ditëve me një pëlqim nga ministria e pushtetit lokal dhe kemi shmangie nga asambleja komunale. Sa i përket numrave është një e mirë se pas një kohe të gjatë nuk po figurojnë të hyrat e njëhershme e 300 milionëshit, por tash kemi 20 milion për të cilat kërkojmë sqarime? Sa i përket të hyrave nga doganat kemi parashikim të rritjes së madhe të tyre, do të rritet konsumi, importi, si janë planifikuar këto, kur rrethanat në Kosovës nuk premtojnë rritje të mrekullueshme. Sa i përket shpenzimeve jemi përafërsisht me ato të vitit 2013. Ky projektbuxhet ka edhe anën politike, ku parashihen rritje pagash në kohën e zgjedhjeve, siç ka ndodhur edhe para katër vitesh. Ministër kjo është thjesht një politikë elektorale, se rritja e pagave ka mundur të ndodhë në formë suksesive nëpër vite. Ajo çfarë është e dyshimtë, pse nuk ka kthim të kredive nga KEK-u, dyshimi qëndron në mundësinë e ekzistimit të ndonjë marrëveshje për shterjen e këtij borxhi, kur dihet fakti se KEK-ut që disa vite i jepen mjete në formë të huaje nga buxheti i Kosovës? Sa i përket bruto produkti vendor është shumë që manipulohet vitin e kaluar dhe këtë vit ka qenë 4 miliard e 700 milion euro, e tash po e shoh 5 miliard e 500 milion euro, a është për shkak të rregullës fiskale prej 2% apo ku bazohen ky ndryshim me saktësi?

Xhevdet Neziraj buxheti është prioritet i qeverisë edhe e qeveria i ka caktuar prioritetet e veta mirëpo lirisht mundem me thënë se edhe viti 2014 do të jetë i njëjtë me vitin 2013. Planifikimet buxhetore dhe të hyrat na rikujtojnë vitin 2013 dhe janë vetëm 2% rritje dhe mbetet të shikohet sa a do të mund të përmirësohet jeta e qytetarëve dhe zhvillimi ekonomik. Është një shqetësim tek të hyrat, dhe unë në raportin nëntëmujor kam vërejtur se të hyrat doganore nuk janë realizuar siç janë planifikuar në vitin 2013 dhe për mua është një frikë se a do të mund të realizohen të hyrat doganore të planifikuara në vitin 2014. Por në anën tjetër shpresoj që Ministria e Financave, unë si opozitë dhe të tjerët me kontribue që ATK të rrit kapacitetet për ngritjen e të hyrave vendore, për arsye se të hyrat doganore në një të ardhme të afërt do të bien, sidomos pas marrëveshjeve tregtare dhe Kosova nuk do të duhet në një pjesë kaq të madhe të varet në të hyrat doganore. Sa i përket nenit 4 që përmendi edhe z. Osmani është një vërejtje në përgjithësi për arsye se komuniteti serb e kemi të qartë se i ka fituar disa të drejta më shumë se disa komunitete tjera. Por do të iu referohem Ministrisë së Integritetit Evropian që para disa ditësh me z. Pjer Mirel promovuan prapë një strategji, dhe nuk janë ndarë mjetet financiare dhe është vështirë me këtë qasje të integrohen ato komunitete. Edhe në ministrinë e punëve të brendshme për riatdhesim i është ndarë i njëjti buxhet dhe do

të kemi problem me të kthyerit. Si përfaqësues i komunitetit egjiptian, por edhe grupi parlamentar i aleancës, i kemi vërejtjet tona që do të paraqiten gjatë leximit të parë dhe presim që mos ta shantazhojmë këtë buxhet, mos ti lejmë njerëzit pa paga dhe jemi të përmirësohet ky draft dhe të kemi një buxhet funksional për të gjithë qytetet e Kosovës për të gjitha komunat dhe subjektet.

Besim Beqaj është viti i parë që hyjmë me një rregull fiskale në buxhet, e nëse e krahasoni deficitin buxhetor të vitit 2013 që ka qenë 3.5 %, vitin ardhshëm parashihet të jetë 2% që tregon se buxheti ka rritje edhe ka respektuar rregullën fiskale. Të hyrat janë rritur 2.5% krahasuar me këtë vit. Sa i përket të hyrave nga doganat kemi një rritje më të moderuar sepse janë trendet ekonomike që kemi ardhur në një analizë përfundimtare se kemi tendencë të stabilizimit të importeve, këtu do të ndikojë edhe rritja e akcizës së duhanit që është vendosur këtë vit. Po ashtu kemi rritje të të hyrave nga ATK, pra kemi tendencë të grumbullimit të mjeteve vendore dhe në mënyrë të drejtpërdrejt ndikon edhe në rritje ekonomike sepse aktiviteti i brendshëm ekonomik mundëson edhe rritje të eksporteve dhe tendencën për të përmirësuar bilancin tregtar. Për shpenzimet është e vërtetë se përafërsisht janë të njëjta por duhet kuptuar që kemi pas një projekt të madh kapital, por tani kemi shumë më shumë projekte kapitale. Sa i përket bankës komerciale kemi të bëjmë një bankë të autorizuar edhe licencuar konform rregullave të republikës së Kosovës dhe kjo bankë është përzgjedhur nga komisioni evropian dhe është NLB-ja dhe të hyrat që shkojnë këtu, kalojnë përmes thesarit. Sa i përket limiteve për komunat janë dy qështje, një është çështja e grantit qeveritare që është përcaktuar me ligj dhe komunat kanë fleksibilitetin e nevojshëm për të bërë akomodimet konform prioriteteve të tyre të cilat, që ka qenë edhe kërkesë e FMN-së, do të kalojnë përmes kuvendeve komunale dhe në ministrin e financave duhet të aprovojme pasiqë të kalon në kuvend komunal. Sa i përket çështjes së kredive të KEK-ut jemi në proces të diskutimit me KEK-un për huat e marruar.

Kryetarja theksoi se në vazhdimësi është përpjekur komisioni për buxhet e financa ta luaj rrolin e vet në çështjen e stabilitetit makrofiskal dhe në vazhdimësi ka bashkëpunuar me ministrin e financave në mënyrë që të respektojmë çështjet e harmonizuar me FMN. Ne si komision e kemi detyrë e obligim të shqyrtojmë edhe pjesën tekstuale por edhe pjesën tabelore të projektligjit. Në pjesën tekstuale shqetësimet të cilat u ngritën duhet me ba ndërhyrje, nuk ka qenë e nevojshme të shkruhet banka komerciale por me shenue për qka është fjala, për një bankë të autorizuar.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Komisioni me gjashtë vota Për (Safete Hadergjonaj, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Jelena Bontic, Duda Balje dhe Sevdije Lama), një Kundër (Naser Osmani) dhe një Abstenim (Xhevdet Neziraj), nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë në parim Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2014.

Mbledhja përfundoi: 10:15

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Safete Hadergjonaj